

# Çelet sezoni turistik veror në Pogradec, priten 50 mijë turistë

## TURIZËM ELITAR

Në fillim të muajit qershor, në qytetin e Pogradecit është çelur zyrtarisht sezoni i ri turistik për verën e vitit 2010, me një ceremoni madhështore, me këngë e valle, të organizuar nga Bashkia e qytetit. Këtë vit Pogradeci ofron mundësi e kushte më të mira për turistët e vendit e të huaj, pasi nga viti në vit ky qytet po zbukurohet dhe po marr një pamje shumë magjepse. Sipas Bashkisë, mendohet që Pogradecin ta mësyjnë rreth 50 mijë turistë nga vendi e të huaj.

Veçanërisht vitin e fundit janë bërë investime të rëndësishme në këtë qytet, si në infrastrukturë, në rregullimin dhe sisteminin e rrugëve, ashtu edhe në zbukurimin e pamjes së qytetit, në përmirësimin e kushteve nëpër hotele e banesa, si dhe përgjatë bregut të liqenit, me pastërtinë e ujit, por edhe të zonës së plazhit. Në prag të sezonit u përrua edhe shtatorja e bukur e shkrimtarit të madh Mitrush Kuteli, që së bashku me atë të Lasgushit, i japin hijeshi dhe e bëjnë këtë qytet shumë të dashur dhe të preferuar për pushuesit e shumtë.

Sezoni i ri turistik është edhe një sfidë për pushtetin lokal, që duket se e ka marrë seriozisht këtë vit.



## Isa e Feride Alla, punëtorë e të palodhur

Nga SAMI LEKA

## PROMOVHET LIBRI ME POEZI "DHE DY PIKLA UJË BËJNË DASHURI..."



Redaksia e gazetës falenderon z. Petrit Shuli për sponsorizimin e këtij numri



## Berisha inauguron shkollën e mesme të bashkuar "Dëshmorët e Pojskës" në Udënisht

## AGAVA - Vajza e Kadmit

Nga Haki BALLIU

## Princeshë e dashuruar

Poezi nga Ornela TORRA

faqe 5

BASHKËBISEDIM MES MIQSH!

## Nusja e bukur

E panjohura "mistike" në jetën e shkrimtarit Istref Haxhillari!

Nga Koço PIHONI



## KËSHTJELLAT NË KRAHINAT E MOKRËS, OHRIT DHE STRUGËS

Nga Bernard ZOTAJ

Me Skënderbeun dhe lufrat që u bënë në këto krahina lidhen edhe kështjellat e zbuluara nga ekspedita arkeologjike. Zbulimet e bëra në Gurin e Pishkashit në Librazhd, i njohur në popull si "Sofra e Skënderbeut" Në gërmimet e bëra janë nxjerrë material, që i përkasin periudhës së mesjetës. Këto kështjella me pozicionin e tyre strategjik mund të jenë përdorur nga Skënderbeu megjithëse burimet bashkëkohore nuk i përmendin. Por dimë se në atë zonë janë zhvilluar disa beteja nga ushtria e Skënderbeut. Nga pozicioni i tyre në kufijtë lindorë të vendit vështirë është se janë lënë pa u shfrytëzuar nga Skënderbeu, si pika vrojtimi për betejën e Torviollit dhe pritë e Mokrenës që janë zhvilluar në vitet 1444, 1445, dhe 1462, patën një rëndësi të veçantë. Rëndësi mërrin dhe krahinat e Mokrës, Ohrit dhe Strugës të cilat shërbenin si pika nisje të ushtrive osmane, Këto toka nga veriu e verilindja kishin si mbrojtje malësitë që ishin gati të pa kapërxeshme. Nga lindja siç tregojnë burimet e shumta osmane dhe bizantine vinin rrugët kryesore të fushatave armike për të pushtuar vendin tonë. Në këto rrugëkalime kishte kështjella të shumta që mbyllnin drejtimet strategjike për në Krujë. Skënderbeu i kushtoi një rëndësi të veçantë që ndryshimisë së kështjellave. Ato duhej të ishin kurdoherë të gatshme për të përballuar dhe mposhtur çdo fushatë të forcave osmane. Kështjellat siguroheshin jo vetëm me forca por dhe me armatime e ushqime të bollshme. Në to kishte puse uji dhe lera për të grumbulluar ujin e pijshëm.

Sipas rëndësisë së kështjellës, Skënderbeu caktoi komandantët e forcave që të mbronin ato. Në rrethimin e kështjellave osmane për pushtimin e tyre përdorën të gjitha format, rrugët mjetet e kohës, duke përfshirë artilerinë e rëndë, duke u gjenur përballë një qëndrese të fuqishme nga forcat që mbronin kështjellat, të cilat sulmit të forcave osmane iu përgjigjën me mbrojtje aktive. Skënderbeu synonte që t'i mbanin forcat osmane sa më larg

mureve të kështjellave, duke i goditur me shigjeta dhe gurët që hidhnin balistat e katapultat. Kur osmanët u afroheshin mureve kundër tyre ata lëshonin gurë, ura të ndezura, ujë të nxehtë dhe huj me majë të mprehtë. Asnjë kështjellë nuk u pushtua me sulme nga osmanët, as nga paftësia e luftëtarëve por vetëm me tradhëti. Bashkëkohësit e tij dhe kronistët osmanë ishin të detyruar të pohonin se, kështjellat shqiptare ishin të pa thyeshme, sepse i mbronin luftëtarë trima e të vendosur dhe se ishin të fortifikuar mirë. Në veprat e Barletit shohim qartë kujdesin e madh që regonte Skënderbeu për fortifikimin e qyteteve dhe të vendosjes në to të gjithëçkaje që i nevojiteshin luftëtarëve dhe popullsisë që ishte në to e strehuar për tu mbrojtur dhe luftuar. Gjatë rrethimit të tyre në përputhje me taktikën që përdorte, Skënderbeu nuk i linte që të përballonin gjithë peshën e sulmit të forcave osmane nga garnizoni që ishte në kështjellë. Ai kundërsulmonte forcat osmane në shpinë duke i vënë midis dy zjarreve, i gjakoste e raskapiste, u ulte moralin dhe ngjallte panik në radhët e forcave osmane duke lehtësuar punën e forcave që mbroheshin në kështjellë duke mundësuar heqjen e rrethimit. Sulltanët duke ndeshur në një qëndrueshmëri të fortë dhe në një moral të latrë të ushtrisë shqiptare harxhuan forca të pa llogaritime për marrjen e tyre. Edhe pse u morën me tradhëti Stefigradi dhe Modrica, kështjellat e tjera në mënyrë të veçantë Krujën nuk mundët ta pushtonin edhe pas rrethimeve të gjata. Kështjellat shqiptare veçanërisht Krujën, osmanët nuk e mposhtën dot me anën e forcës së armëve. Ato ranë në duart e osmanëve pas sulmeve të gjata kur i mundi uria, tradhëti e pas vdekjes së Skënderbeut. Në luftën e pabarabarte shumëvjeçare të popullit shqiptar, kundër pushtuesëve osmanë, kështjellat e fortifikimi i tyre e justifikuan plotësisht kujdesin që u tregua nga Skënderbeu dhe shtabi i tij për to. Ato i shërbyen më së miri strategjisë e planeve taktike të tij për mbrojtjen e vendit.



## Kryeministri Berisha inauguron shkollën e mesme të bashkuar "Dëshmorët e Pojskës" në Udënisht

Kryeministri Berisha mori pjesë në inaugurimin e përfundimit të punimeve dhe pajisjes së shkollës së mesme të bashkuar "Dëshmorët e Pojskës" në Udënisht, në Pogradec. Shkolla, me vlerë investimi 26 milion leke të reja, ka 567 nxënës, nga të cilët 110 në arsimin parashkollor. E ndërtuar sipas parametrevë më të larta bashkëkohore, kjo shkollë ka 21 klasa, laboratorë modern informatike, bibliotekë, si dhe mjedise komode për nxënësit. Gjatë qeverisjes demokratike në rrethin e Pogradecit janë investuar 50 herë me shumë se në qeverisjet e mëparshme socialiste. Në infrastrukturë janë investuar 70 milion lekë për ndërtimin e rrugëve nacionale. Janë ndërtuar gjithashtu 23 rrugë rurale e të qytetit, 11 ujësjellës, 16 shkolla dhe 17 ambulanca. Është investuar në ujësjellësin e kanalizimit e qytetit dhe impiantin e përpunimit biologjik të ujërave të ndotura. Qeverisja aktuale ka investuar dhe subvencionuar në bujqësi e peshkim 7 herë më shumë, se qeverisjet e mëparshme socialiste. Kështu, në Udënisht është investuar 20 herë më shumë, se në qeverisjet e mëparshme, duke ndërtuar 3 rrugë, ujësjellësin dhe shkollën.

Ndër të tjera në fjalën e tij, Kryeministri Berisha u shpreh: "Së pari, ju përshëndes ju dhe të gjithë qytetarët e Pogradecit, kudo që janë sot, ju uroj gëzuar inaugurimin e shkollës së re, moderne, me të gjitha pajisjet, një shkollë e vërtetë e standardeve euro-

piane. Sikundër, dua të garantoj sot, fëmijët e Pogradecit se në të katër anët e këtij rrethi dhe në mbarë Shqipërinë, shkollat do të bëhen si kjo që inaugurojmë sot. Në tre vjet, ne do të ndërtojmë dhe rindërtojmë të gjitha shkollat e këtij vendi, që fëmijët shqiptarë të ulen në klasa moderne, njëjloj si bashkëmoshatarët e tyre në mbarë Europën. Pesë vitet e fundit ishin vitet e ndryshimeve të mëdha të Pogradecit dhe mbarë Shqipërisë. Sot, liqeni i Ohrit, ky monument madhështor i natyrës në mbarë planetin, është në brigjet shqiptare, një nga liqenet më të pastër në Europë. Jam këtu për t'u zotuar se kolektori do të shtrihet, ashtu siç ka qenë premtimi i parë, nga Lini në Tushemisht, sikundër, dua t'ju garantoj se do ecet me shpejtësi drejt shndërrimit në bulevard të vërtetë, me trotuare dhe ndriçim, e të gjithë rrugës, nga Lini në Tushemisht.

Me gjolin, natyra ju ka dhuruar një nga bukuritë më mahnitëse të tokës. Ne do të ndërtojmë këtu infrastrukturën më moderne, për të bërë që ju të njihni me shpejtësi bumin e madh turistik që meritoni. Qeveria ka ndërtuar në këtë rreth, me dhjetëra e dhjetëra rrugë të reja, por gjatë këtij mandati, në këtë rreth nuk do të ketë qoftë edhe një rrugë të vetme të paasfaltuar."

Pas vizitës në mjediset e reja të shkollës, Kryeministri Berisha u takua me nxënës, mësues e qytetarë të tjerë të pranishëm në këtë inaugurim.

.....

## HAPET NË POGRADEC FILIALI I UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", PËR POGRADECIN "CIKLI I ULËT DHE ANGLISHT NË CIKLIN FILLOR,"

Në mbledhjen e Qeverisë të datës 12 maj 2010 është vendosur gjithashtu hapja e programit të studimeve të ciklit të dytë, në "Filozofi Sociale", në Fakultetin e Mësuesisë, të universitetit "Fan S. Noli" Korçë. Programi i studimeve të ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është dy vite akademike. Kuota e pranimit në këtë program studimesh, për vitin akademik 2010-2011, është vetëm 20.

Universitetit "Fan S. Noli", Korçë i jepet e drejta për të përcaktuar kriteret e pranimit të kandidatëve, të cilët duhet të bëjë publike paraprakisht. Tarifa e shkollimit për këtë program studimesh të ciklit të dytë, për vitin akademik 2010-2011, është 60 mijë lekë dhe studimi i nënshtruhet vetëm një tarifë vjetore shkollimi. Në këtë universitet është miratuar edhe hapja e programeve të studimit të ciklit të parë në "Biologji-Kimi dhe "Histori-Gjeografi". Gjithashtu, përherë të parë, këtë vit akademik do të çelet në qytetin e Pogradecit një filial i Univer-

sitetit "Fan S. Noli" Korçës. Gjatë vitit 2010-2011, aty do të nisë programi i studimit të ciklit të parë "Cikli i ulët dhe anglisht në ciklin fillor" Programet e studimit realizohen me 180 kredite ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tyre është tre vite akademike. Në vendimet e miratua janë përdorur termat e ligjit aktual për arsimin e lartë si, DNP, DND, Master i nivelit të parë etje. Në fakt sipas Ministrisë të Arsimit, Myqerem Ttafaj, të gjithë të diplomuarit e ciklit të parë të studimeve, duke filluar që nga ky vit nuk do të pajisen me diploma të nivelit të parë, por me diplomën e njohur ndërkombehtarisht si Bacheltor. Ndërsa sipas ligjit të ri në përfundim të programit Diplomë e Nivelit të Dytë, studentët priten të pajisen me Master shkencor dhe jo sikundër janë culësuar në vendimet e mësipërme DND. Deklarëton për ndryshimin e titujve të diplomave, ministri e ka bërë gjatë një dalje publike, ku ka shpeguar ristë që sjell ligji i ri për arsimin e lartë që pritet të miratohet së shpejti.



### HOTEL "PERLA"

\*\*\*

**Hotel Perla \*\*\* - Hoteli i ndërtuar krejtësisht i ri, i mobiluar me shije dhe i menaxhuar në mënyrën e duhur, ndodhet buzë Liqenit të Ohrit, përgjatë shëtitorës së qytetit, 20 m nga plazhi i Pogradecit. Ju mirëpret në Bar, Restorant, kuzhinë të pasur, muzikë romantike në sfond. 9 dhoma, 1 apartament, TV, Shërbim dhome, Telefon**

Address:  
Rruga "Dëshmorët e Pojskës",  
Lagja1, Pogradec, Albania

Tel. +355  
0682320160  
0692390220  
Fax: +355  
0832 6688



# Nusja e bukur

E panjohura "mistike" në jetën e shkrimtarit Istref Haxhillari!

## Prezantimi për lexuesin e nderuar!

I dashur z Haxhillari, është kënaqësi për mua t'ju kujtoj se jeni një shoku im i vjetër dhe shumë i shtrenjtë për mua. Më saktë, që nga viti 1977 kur unë u caktova për të punuar si specialist bujqësie për disa vjet në Dunicë të Mokrës. Domethënë u bënë 33 vjet që njihemi, një jetë e tërë, aq sa ka jetuar edhe Jezu Krishti. Besoj se kjo kohë miqësie është domethënëse dhe e mjaftueshme për t'u njohur e për të patur diçka për të thënë, në një intervistë si kjo. Unë ruaj shumë kujtime prej atyre viteve, por do të veçoja disa, një pjesë prej tyre që janë më përgjithëse për ju. Veçanërisht njohjet me ju në pozicionet si drejtues shkolle apo dhe si "komisar partie" në ato vite, ku besoj se, mbi të gjitha, ka spikatur aftësia juaj si drejtues, organizator, nismëtar, novator, si njeriu i ndërmarrjeve të veprimeve konkrete, pra si një njeri i komunikueshëm dhe me shpirt të madh, gjithmonë i gatshëm për t'u ardhur në ndihmë njerëzve nevojtarë, sidomos ata që gjenden në rrethana të vështira që sjell jeta dhe, për fat të keq, ata ishin të shumtë.

Njeriu tipik që karakterizon mokrarin e zgjuar, punëtor, mikpritës e bujar të vërtetë, që e ka mbajtur, realisht portën e shtëpisë të hapur për shumë shokë, miq, nga fshati e qyteti, më shumë bujari e me zëmër të mirë. Kujtoj se ato vite ishin të paktë televizorët dhe shpesh shtëpia juaj kthehej në "vatër kulture" për të ndjekur festivale këngësh, botërore futboll, filma etj, për të cilat do dëshiroja t'u falënderoja edhe unë sot. Ne nuk mjaftoheshim më këto bezdira që u krijonim familjarisht, por duhej të harxhoje edhe nga një shishe raki se, doemos, "njeriu për një nder rron" dhe si shpërblim ju kini marrë vetëm mirënjohjen dhe falënderimet tona të pakursyera, vetëm kaq.

Do dëshiroja të sjell në vëmendjen tuaj dhe të lexuesit, nostalgjinë e gjithë atyre viteve, duke kujtuar se ajo Dunicë kishte atëherë 300 shtëpi e rreth 1500 banorë, të cilët e bënin atë fshat një qytezë të vërtetë. Kishte shumë gjallëri, sidomos në orët e mbasdites në qendër, si në asnjë fshat tjetër të Mokrës së Sipërme se Dunica quhej "Kina" e Mokrës. Unë do vlerësoja maksimalisht rolin tuaj si drejtues partie, për një vit bujqësor aso kohe. Vlerësoj atë frymë bashkëpunimi që ngjalle e krijove, midis pushteteve si atij partiak, Këshillit të Bashkuar, Kooperativës Bujqësore, Arsimi, S.M.T, Shëndetsisë, Tregtisë, Postë-Telegrafën, Ndërmarrjeve të patronazhit etj. Ishte një bashkëpunim i frytshëm që të sjell në mendje një kohëre që gumëzhinte në atë kohë. Më kujtonte një roman sovjetik të asaj kohe që titullohej, "Trëndafili në Sakënë", që tregonte përpjekjet e njerëzve me idenë se kudo mund të jetohej. Do dëshiroja të kujtoja një pjesë të atyre kuadrove e të specialistëve që kam njohur e me të cilët kemi punuar ato vite, si p.sh G Xhaja, I. Agastra, F. Sherin, Sh. Xhaja, R. Lazellari, I. Dita, T. Spahiu, N. Sofi, L. Abrashi, A. Larashin, P. Kalanxhi, I. Xhaja, H. Mane, G. Lazellari, A. Muci, P. Starova, R. Mullaj, L. Maliqi, G. Çollaku, Sh. Çollaku, R. Rollaku, H. Velillari, S. Spahiu, T. Spahiu, N. Spahiu, Sh. Sofi, B. Kajaçka, D. Sofi, N. Çollaku, A. Petre, D. Haxhillari, T. Maxhari, B. Xhaja e shumë të tjerë. Do kujtoj dhe disa bujq e blektorë e zejtarë si B. Kajaçkën, P. Xhaja, N. Agolli, B. Sulollarë, A. Sofi, S. Kozica, M. Haxhillari, L. Spahiu, T. Agolli, Q. Agolli, M. Sofi e Sulon, kovaçin etj etj.

Ishte puna, aftësia e përkushtimi juaj që bëri, që ju bëri të emëroheshit drejtor i shkollës së mesme në Trebin-

jë e më pas Shefi i Seksionit të Arsim e Kulturës së rrethit, për disa vjet edhe sot të jeni mësues i nderuar në gjimnazin "Muharrem Çollaku" të qytetit, tashmë edhe një njeri i afirmuar i letërsisë artistike, në gjininë e prozës.

Është kënaqësi për mua, që në intervistat që kam marrë me njerëz të letrave, si p.sh kujtoj ato me Niko Nikollën, Dritëro Agollin, Dhimitër Xhuvani, Gjergji Gusho, Dhimitër Pojanaku, Vasillaq Vangjeli, Nasho Jorgaqi etj. Sot jam me ju e për ju, i dashur z Haxhillari. Dhe ja pyetja e parë për ju:

**-Sa ndikojnë në krijimtarinë tuaj mitet, legendat, përrallat, tradita?**

**Istref Haxhillari:** - Të gjitha zhanret e artit, veçanërisht të shkruarit, nuk ngrihen mbi asgjë. Lënda e shkrimtarit janë njerëzit me jetën dhe bëmat e tyre nëpër kohën e shkruar apo të sotme, vendet që i njeh më mirë, historia. Orhan Pamuk shkruan për Stambollin, hoxhallarët, kulturën islame mbi të cilët ndërthuren fizikisht e tij letrare, me vlerë të përbotëshme. Kadareja ve në qendër të shkrimeve Gjyokastrën, kështjellat, Tiranën, Shqipërinë, politikën e kohës, se ato i njeh mirë. Shkrimet e mija evokojnë Mokrën, Pogradecin dhe vise të tjera të dashura që më ngacmojnë pareshtur. Në fëmijërinë time më kanë treguar përralla të çuditshme me xhinde, sprija, botën e poshtme të të vdekurve, legjenda, histori trimash me kapedanë dhe komitë.

Personazhet fantastikë lëvrinin në këtë territor nga Valamara në Malin e Thatë, nga brigjet e Shkumbinit në Liqenin e Ohrit. Më shumë përralla dinte nëna. Kur i mbaronte të gjitha fillonte nga e para. Unë thartohesha, ia prisja fjalën dhe vazhdoja ta tregoja historinë deri në fund i skinjur nga inati. Habitej ajo që unë i mbaja mend pikë për pikë, pa harruar asnjë detaj. E dëgjova njëherë t'i thoshte hake Këzes, që e kishim tonën: "E gënjeva se më çmëndi, sajova një përrallë vetë. Kisha harruar si përfundonte, po më merrej goja, kur ai e vazhdoi deri në fund, ke parë kështu malukati?"

Jetoja ditë për ditë me historitë, përpiqesha t'i imitoja kapedanët të folurit, sjelljet. Kështu i mbaja mend tërë jetën pa e ditur se do më duheshin kaq shumë. Romani "Pesha e kohës" e ka zanafilën në rrëfenjën e nënës, për dashurinë e gjyshit tim çapken. Novelat "Muzgje të thinjur", "Klithma e hesh-tjes", tregimet "Iradeja", "Plasaritje malli", "Keq e më keq", eseja e gjatë "Hapësirat rrallohen gjatë prej dhimbjes" etj, janë ngritur mbi historitë dhe legendat pafund të vendit tim. Profesor Adriatik Kallulli që shkroi një artikull të gjatë për romanin "Pesha e kohës", më tha: "Nëse do bëhesh dikush në letërsi, mos iu ndaj vendlindjes!"

**-Keni shkruar dhe botuar. Disa nga krijimet tuaj janë vlerësuar me çmime. Cilat konkretisht?**

- Kam botuar përmbledhjen me tregime "Përthyerja", romanin "Pesha e kohës", prozat "Bari i ukut", novelën "Ëndrrat kryqëzojnë kohën", Esenë filozofike "Hapësirat rrallohen prej dhimbjes". Më 23 janar 2010 mora çmimin e tretë për tregimin më të mirë të vitit 2009, në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, akorduar nga revista

letrare "Obelisk", me tregimin "Thikat e Vardarit". Dy muaj më vonë, më 23 prill 2010, në Ditën Botërore të Librit, fitova çmimin e madh "Don Kishoti", akorduar nga Ambasada e Spanjës në Tiranë për tregimin "Karmençita". Trofetë e dy viteve të fundit më kanë gëzuar, nuk kam përse ta fsheh sepse janë vlerësime për punën e mundimshme. Të shkruash është marrëzi. Ditë e net të tëra përpara kompjuterit në përpjekje sfilite të krijosh mbi subjekte që të lenë pa gjumë. Shpenzimet e botimit duhen përballuar nga kursimet e familjes, shpërndarja dhe shitja, procese tërësisht private. Këto janë me pak fjalë thelbi i kësaj marrëzie. Nga ana tjetër vesi i të shkruarit është aq intrigues sa droga apo kumari. Në këtë kontekst, trofetë janë shpërblimi i rrallë, ngashëryes, të bëjnë të mendosh se shkrimësia nuk të dhuron shumë kënaqësi, por është më shumë, do ta quaja një marrëzi e këndshme!

**-Mendimi juaj për famën, keni ambicie, për t'u bërë i famshëm?**

- Kur ulem për të shkruar, nuk mendoj asgjë tjetër veçse të derdh shpirtin mbi tekst, të jap maksimumin e mundësive të mija. Të shumtën e rasteve koha rrjedh dhe unë nuk mund të shkruaj asgjë, ose rreshtoj disa fjalë që i prish sapo i mbaroj. Kur shkrimi merr formë të pranueshme si përmbajtje, më jep kënaqësi të pamatë, lumturi dehëse. Pastaj vjen përpunimi, gjetja e fjalëve të pakonsumuara, pastrimi nga fjalët parazitare, lërimi i frazave, mbushja me fraza letrare, korrektimi. Ky proces zgjat disa herë më shumë nga hedhja në letër e idesë fillestare, ndonëse bëhet më lehtë. Gjuha shqipe është minierë fjalësh të bukura, lundrimi nëpër to nuk ka të sosur.

Kohët e fundit shkrova tregimin "I huaji". Idenë e kam hedhur në kompjuter para shtatë viteve. Sa herë tentoja nuk qulloja gjë dështoja, derisa personazhin, Kocin, e takova një ditë, pimë kafe, biseduam. Pas këtij ngacmimi tregimi rrodhi vetë. E shkrova për një javë. Lëmimi zgjati më shumë se një muaj, nuk e lëshova dot nga duart derisa në variantin e njëmbëdhjetë nuk ndryshova dot asgjë dhe e lashë. Kaq qe takati im. Nëse ke talent dhe punon me vullnet të çeliktë, fama vjen vetë.

Siç thotë Lasgushi, "mund pa fund për art magjie".

**-20 vite të shkuara, në vitin 1980, nga Presidiumi i Kuvendit Popullor i R.P.S. të Shqipërisë, iu akordua një dekoratë, urdhri "Naim Frashëri Klasi i Parë" zotit Safet Spahiu, me motivacionin: "Për kontribut të shquar në lëvrimin e këngës të kësaj treve..." etj. Dhe ky burrë, mbasi mbaroi ceremonia e dorëzimit të kësaj dekorate, i drejtohet të deleguarit që kish ardhur nga rrethi dhe, përveç falënderimit, i tha: "Shoku Tomi, së bashku me ata shokët do urdhërosh për darkë nga unë sonte, që ta marrë vesh gruaja se ç'burrë ka!". Pyes, bashkëshortja juaj, a ndjehet me fat, për burrin që ka?!**

- Për këtë duhet pyetur Shpresa. Unë di të them se jam burrë me fat, madje me shumë fat. Gra të tilla janë fort të rralla. Me sa duket ky është shans i burrave të mirë. Më ka qëndruar pranë në të gjitha tallazet e jetës së deritanishme. Prindërit e mi e donin

se i respektoi dhe i rrethoi me mirësi deri sa dhanë frymë. Kemi tre fëmijë të mrekullueshëm, që i duam shumë, sidomos ajo. Djali që jeton në Florida, kur del në internet dhe më shikon mua thotë: "Ku është Loci? Ore babi, mos e nga mamanë se je ca trazavaç ti!". Për këtë të fundit s'ka fare të drejtë. Ajo përgjigjet e malluar gjithnjë: "Bir i mamit, sa më ka marrë malli!" - shpesh i rrjedhin lotët.

Pikë të dobët kemi nipin, Rikardon, që ka lindur në Itali dhe në 5 maj mbushi tre vjet. E njohim vetëm përmes internetit, akoma s'e kemi prekur me dorë, as e kemi përkëdhelur. Dhimbje e madhe, plagë e trishtë e kurbetit të hidhur. Vajzën mësuëse dhe dy fëmijët e saj, Gresin dhe Eordein i kemi çdo ditë pranë, na falin kënaqësi të pamatë sa herë zhurmojnë që nga dera e jashtme. Dei thërret që jashtë: "Bubu erdha unë, po mos më kafsho! Grejsi e vogël, posa filloj të flistë më quajti Bubu dhe kështu më mbeti. E vërteta është se nuk desha të më thërisnin gjysh, pasi nuk e ndjej veten të tillë. Thonë se Shpresa është më e mirë se unë. Kudo e duan dhe e respektojnë. Për dhjetë vjet kam qenë drejtues i arsimit në rreth. Asnjëherë nuk u mburr, kurrë nuk ndërhyri në punët delikate aq sa shpesh mikeshat e saja nuk e dinin se i shoqi ishte shef, që kishte shumë gjëra në dorë. Jo rrallë ato që e njohin më thonë: "Lum për atë grua që ke, nuk di të thotë një fjalë të ligë!". Ndihem mirë që shkruaj. Nganjëherë i redakton. Mendohej të më krijojë kushte pune, pa u mërzi-tur asnjëherë.

Nga orët e gjata të vetmisë, kur unë punoj në kompjuter deri afër mesnatës.

**-Kur punoja në vendlindjen tuaj, kam njohur një burrë të vjetër, plak por shumë fisnik, xha Kajanë, prej të cilit ruaj e kam treguar shumë kujtime të rryfjera prej tij. Ai ka qenë për ju dajua nga ana e nënës tuaj, çfarë mund të kujtoni nga ai, se të vdekurit flasin me gjuhën e të gjallëve, thoni ju në librat tuaj! Cili është komenti juaj?**

- Kajan Sofi ishte dajua im nga nëna. Kur unë mbarova universitetin, babai im, që pinte një kile raki pa iu dridhur qerpiku i syrit, shtroi një darkë të madhe. Ishte krenar për djalin që mbaroi shkollën e lartë në Tiranë dhe ia kaloi të gjithëve, edhe atyre të qytetit. Atë natë rakia u pi lumë, dasmë e shkua dasmë, po dajo Kajani nuk erdhi se qe plak dhe i paralizuar. Pas disa ditësh nëna ime, më e mira dhe më e mënçura e të gjithë grave që kam njohur, më tha: "Bir i tatasë, shikoje Kajanin se është sëmurë!"

Në atë kohë, djalë i ri, i dhënë pas mësimëve, nuk kisha asnjë ves, këto i mësova më vonë. Dajua gjysmë i paralizuar rrinte në një cergë, nën hijen e kumbullës i vetmuar, larg njerëzve. Iu bë qejfi kur vajta dhe nuk dinte çfarë të bënte. Drodhi një cigare nga kutia e ma zgjati. Unë tërë krenari u përgjigja: "Dajo, nuk pi duhan!", - sikur prisja të më përgëzonte. Ai nuk bëri zë, por i thiri Tufes, së shoqes: "Plakë piq një kafe për djalin!". Unë, sërish e shikova drejt në sy me krenari, demek shiko çfarë nipi ke dhe i thashë: "Kafenë nuk e ve në gojë!". I zymtuar ma mbushi një gotë raki nga faqorka që s'e ndante kurrë. "Raki nuk pi se më bën dëm", u mburra unë, djalë i shkolluar në Tiranë. Ai u vrenjt dhe më shikoi drejt në sy me inat: "Po çfarë bën ti, more bir?" "Lexoj libra tërë ditën", i thashë. Rënkoj i zhgënjyer dhe më tha tërë pezëm: "Djalë, të paska prishur Tiranë! Burri që nuk pi dhe nuk bën ca punë të tjera, nuk është burrë!". U mbështet mbas tringut të kumbullës, nuk ma vari më.

(vijon në faqen 7)



Nga Haki BALLIU

# AGAVA

vijon nga numri i kaluar **2**

## Vajza e Kadmit

(Tregim sipas rrëfimeve mitike)

### Ç'mund të na rrëfente një personazh i mitizuar çudibërës

*"Unë Zoti i lashtë i kësaj toke, ku mërmërin liqeni i Enkeljeve kam njohur aq engjëj e djaj, profetë dhe Zota, sa kam thinja në kokë. Mos më fajësoni pse thërras e përmbys kohët, sjell e kosit jetët, fitoj e rrëzoj mbretëri, dashuroj e ndjej drithmën e tradhtisë. Prehja në qetësi nuk është e kësaj bote. Më emërtoni si të doni: mit, legjendë, gojëdhënë apo përrallë me dhembë qeni. Unë kam për mision të përcjell ëndrrat, dritën, frikën, errësirën, vdekjen dhe pavdekësinë. Një herë enkelejntë u rrezikuan nga endacakët jo- njerëzorë dhe thirrën Kadmin shpëtimtar. Zoti im i mëshirueshëm Medaur më ndihua të kryej detyrën time. I thura legjendën Kadmit dhe e vura në gojën e njerëzimit..."*

### I prejardhur prej racës liridashëse

Kadmi s'ishte veçse 18 vjeç kur një fuqi grabitqare i rrëmbeu të motrën, Evropën. U nis ta kërkonte nëpër rrugë të pashkelura, nëpër vende të frikshme, në çdo hap i kërcënuar nga bishat e egra e deri njerëz pylli, të cilët ende nuk kishin kapërcyer fatin e të qenit egërsirë. Mbasi bëri 500 mijë hapa burri u shtri të pushonte afër një lugine. Mbrëmja flaku tutje ditën e lodhshme. Sakaq nata erdhi sa e butë aq e mistershme, pa hënë, e thellë... Si të donte të trembte frikën mendoi të thërriste të motrën: Evroo...!

I qe bërë zakon që emrit të saj t'i hiqte dy shkronjat e fundit. E thirrura ndjellëse nuk mori përgjigje veçse jehonën e zërit të tij. Në çast vuri në dyshim lajmin tronditës të dhënë atë mëngjes herët se Evropën e kishin parë të kapur si flutur në brirët e një demi të bardhë. Demi ishte larguar me një fuqi tërbimi sa nuk e arritën dot as me kuaj e as me luanë. Lajmi si një vdekje e zezë, më shumë nga të gjithë kishte tronditur të atin, Agenon. Ky ishte mbret fenikas i prejardhur nga një racë që digjeshin në çdo 500 vjet e ringjallëshin nga hiri i vet. Mbreti i kishte dhënë urdhrin më të rrepte tre djemve të tij: Feniksit, Çelestit dhe më të voglit Kadmit: "Nëse nuk jeni të zot ta gjeni motrën tuaj mos u ktheni në Tira. E po nuk ja thyet brirët atij djall demi, unë pushoj së qeni mbret lavdidashës."

Kadmi parandiente se shtegtimi i tij do të ishte i mbushur me heroizma. I bënte moral vetes të ishte i duruar, i fortë të mos i trembej vdekjes e të përbuzte çdo lumturi nëse kjo s'do të ishte mirësi hyjnore. Vuri shpatullat mbi atë shtrojë të fortë toke, si të shtrihej mbi dheun e një varri të thatë.

Nuk kishte me kë të fliste, veç me trishtimin e vet dhe fatkeqësinë e së motrës. Një herë pyeti: "Ç' deshe o Evropa të kalëroje mbi një dem të marrë?" më pas po vriste mendjen se deri ku mund ta degdiste ai përbindësh i mallkuar, andej apo këtej Oqeanisë.

Nata i dukej e egër e pabesë, e lodhshme. I duhej të shtegtonte kur nuk kishte kohë për të humbur. Ai sapo e kishte kapërcyer shpirtin prej tregtari sirofenikas, e tani i kishte çelur dëshira për t'u marrë me studime të mëdha: nga ç'kaos ishte formuar toka? E madje çfarë ishte ajo marrëdhënie e përsosur, me të cilën qielli hyjnor mbante varur planetet dhe yjësitë?

### Këshilla e orakullit

Dikur e zuri gjumi. Fjeti qetësisht duke thithur ajrin përzier me një aromë të mirë gruaje. Kur u zgjua, e ëma Telefasa dremiste mbi kokën e tij.

- Ç'që ai Zot që të solli këtu, nëna ime?, pyeti me dhembshuri.

- Zemra bir! Në do të turren bishat më parë le të hanë në mishin tim. Ajo i buzëqeshi me sytë e saj të zi. Çuditërisht e zbukuruar. Flokët i kishte lyer me vaj dafine, në qafë mbante varur stolitë e nusërisë, mes të cilave binte në sy zogu Feniks i punuar në bronz.

Udhëtuan dy ditë të tjera pa lajm e pa rënë në gjurmët e demit. Diku e ëma porositi të birin që të shkolin të këshilloheshin te orakulli i Dodonës. Por pas

natës së tretë Telefasa nuk u zgjua më. I biri lëshoi një klithmë vajtimi: "Ç' pati zemra jote, o nëna ime?". Sapo e rrëmbeu ta ngrinte, nga gjoksi i saj rrëshqiti e ra një gjarpër helmues. Ku ta shpinte trupin e pajetë? Me sytë lart tre herë pyeti: "Zot më thuaj çfarë të bëj?". Pa një re të vogël, si një vogëlushe e bardhë, e cila shkoi e u bashkua me përmasën e madhe. Është shpirti i nënës, mendoi. Kurmi i saj tanimë ishte kthyer në shpirt. E qau dhe e lau me lotët e varur nën gushë, si një vajzë e brishtë. Gjithë ditën i ngriti një varr me mure guri. Qëndroi aty gjersa nata u përkul mbi malet trake. Diku aty rrëfehej se Hera verboi Terezinë, sepse ky gaboi kur pajtoi grindjet e perëndive.

Pas Thrakës udhëtoi gjatë. Në çdo hap ishte i mbytur nga hidhësira për vdekjen e së ëmës dhe fatin e së motrës. Herë ecte nëpër toka të etura për ujë si buza e tij, herë pyjeve të errta me aromë dehëse. Rallë e për mall shkelte në vende të banuara nga blektorë. Prej dikujt mësoi se aty ishte vendlindja e Pellazgut të parë, me të vëllanë Pyti. Njerëzit e atyshëm, Kadmit i dukeshin me vështrim të qartë e me shpirt të pastër. Prej tyre zgjodhi udhërrëfyesin për tek orakulli i Delfit.

Në hyrje të tempullit e priti një profeteshë, e cila dukej se ishte mbyllur brenda mureve në emër të mëkatit. Me mirësjellje të përulur ajo e shpuri Kadmin te kryeprofeti. Sapo i shpjegoi atij se ç'hall e kishte sjellë, goja e orakullit, fshehur në leshra filloi të flasë:

- Ja ku erdhe tek unë, zog fenikas, bir i Agenonit dhe Telefases. Tani dëgjo këshillat e mia dhe pëlqimin e Zotit tim Apollon. Harroje motrën Evropë të rrëmbyer nga Kryeprendia Zeus...

Kadmi u trondit. Ajri brenda u bë shtypës, zemra e shtrëngoi e zëri ju egërsua:

- Më ndje, o shërbëtor i Apollonit, po dua të bëj me dije se motrën time e kanë parë mbi një dem të bardhë e jo në krahët e Zeusit.

- Si nuk e di ti, o kadmos i mjerë se Zeusi është çudibërës? - u habit orakulli. A s'paska dëgjuar se kryezoti ynë e shndërron formën e ngjyrën sa herë i duhet një grua epushndjellëse? Për të rrëmbyer Leden u kthye në mjellmë; kur iu desh Ganimedi në qiell u kthye në një shqiponjë; e për të mashtruar Evropën, në fillim ra si shi i artë e më pas u kthye në dem i bardhë. Kështu edhe për Antinon...

Kadmi nuk dëgjonte më. Rreth tij gjithçka u errësua. Gati sa nuk shpërtheu se Zeusi ishte një qen bir qeni. Por në moment e qetësoi zëri mëshirues i profeteshës që e lëvdonte:

- Nuk po mundem të duroj dot lumturinë që më jep bukuria jote, o djali i Telefases fatkeqe. Siç ke bukurinë, ke edhe mençurinë. Këto nuk duhet t'u falësh rrugëve pa fund. Lëre motrën në dorë të Zotit dhe ndiq këshillat e kryeprofetit.

Orakulli e këshillonte të ndërtonte një qytet të rrënuar e të fshirë nga fuqia e dheut s'dihet qyshkur. Nëse qyteti do të merrte emrin e tij atëherë do të bekohej, në mos shenjtërohej vetë Kadmi. E orientoi se diku do të gjente një lopë me shenjë të bardhë në bark, që i ngjan hënës së plotë. Ai do ta ndiqte kafshën ditë e natë. As do t'i fliste e as do ta ngiste. Atje ku lopa do të ndalonte, aty Kadmit i duhej të ngrinte qytetin.

### Përtej pabesueshmërisë

Lopa e lodhur ndali në Tebë, ndoshta për të marrë një gojë bar. Kadmi e flijoi për perëndeshën Athina. Qysh të nesërmen iu vu punës. Diku në një krua apo në lumin Azop çoi njerëz të mbushnin ujë. Këta ranë viktimë e gjarpër dragua, Zot i burimeve. Kadmi u nis me një frymë. U ndesh me përbindëshin dhe e vrau. Mbasi i shkuli dhembët i mbolli në një tokë të varfër. Nga dhembët e gjarpër mbënë ushtarë të llahtarshëm. Kadmi hodhi një gur dhe i la të vriteshin mes tyre, sepse aq të tmerrshëm nuk i duheshin. Nga ata shpëtuan vetëm 5 të cilët Kadmi i quajti spartë. Me ata ndërtoi Tebën. Po bëmat e tij nuk kanë të sosur. Perënditë e ndëshkuan të shërbente 8 vjet te Zoti i luftës,

Ares, për arsye se i vrau dragoin. Në atë botë magjike Kadmi humbi kohë, por falë mençurisë dhe bukurisë fizike fitoi dashurinë e Marmonës, bijë e Aresit. Martesa e një hyjneshe me një vdekatar pajtoi vetë perënditë. Për këtë arsye Marmona u bekuar me emrin Harmoni. Sa kurioze aq edhe ziliqare, perëndeshat shkuan në dasmë t'i jepnin Kadit çmimin e bukurisë dhe plot dhurtata të shtrenjta. Demetra i solli grurin, Hera stolin e florinjte, e kështu me radhë. Te këto gra me pamje njeriu që mbaheshin për hyjnesha, Kadmi sforcohej të besonte përtej të pabesueshmes.

### Fati im mund të jetë fati juaj

Atë ditë vjeshte, Rea me Biman u nisën të gjenin Kadmin, përqendruar në një fushim qorr si një Zot i fshehur, jo nga frika por nga dëshpërimi. Në Enkeli fama legjendare e Kadmit kishte ardhur më parë se vetë ai. Dihej se burri fenikas kishte shpenzuar shpirtin dhe gjysmën e jetës për të ngritur qytetin e shndritshëm, Kadmen; se ishte profet, i pajisur me dashurinë ndaj së vërtetës dhe dashamirësinë ndaj njerëzve. Mbas shkollimit në Egjipt njihje shkronjat siç njihje edhe yjet. Prej andej u solli grekëve alfabetin fenikas-egjiptian, ndoshta pa e ditur se më parë alfabeti ishte shpikje e pellazgëve. Por çuditërisht perënditë u zemëruan kur Teba, nën mbretërinë e tij lulëzonte. Për t'u lënë hijen të këqijave ishte larguar, i këshilluar nga orakulli i Delfit. E tani u ofronte Enkeljeve dorën e miqësisë. Këta besim nuk i sillnin, por as ushtri i ndërësinin. Rea me Biman ishin përfaqësia e parë, secili në kohën e vet dhe asnjëri me mision mbretëror. Kadmi e gjetën përhumbur teksa hetonte hapësirën e qiellit, ku mali i reve të bardha rrezikonte të pushtonte diellin.

- Zot, - i foli Rea. Në je vërtet Zot, a ke burrërinë të na thuash ç'këmbë e mbarë apo verë e mbarë të solli në Enkelinë tonë?

Pa u befusuar burri flokëbardhë dha përgjigje të shpejtë.

- Vera e fatit të hidhur që bijat e mia ma dhanë me dorën e tyre, - tha me një vështrim mbi bukurinë engjëlllore të Reas. - Doja të ishin kështu molla e jetës, e rritur pa krimbin brenda.

Për Rean dhe Biman, Kadmi u duk burri me sjellje të rralla. Një imazh vezullues i përshkonte sinqeritetin e fytyrës. Vjaza e tij e vogël me emrin Autona rrëmbeu Rean nga dora sikur ta kishte ftuar për drekë. Shëtitën nëpër fushimin mbretëror ku nuk mungonin kuajt, ushtarët e deri kafshë të egra lidhur me zinxhir. Autonën e bëri për vete bukuria e Reas, ndërsa Rean e folura e Autonës në ilirishte. Vogëlushja ezmerkë, kaçurrela e buzëtrashë nuk ngurroi të rrëfente për të fshehtat familjare. Tri motrat e saj i kishte ndjekur fati mizor. Më e madhja Ino ishte vetëflijuar duke u hedhur nga shkëmbi në det, ku i shoqi i kishte hedhur të birin Larakun. E dyta Semela, i kishte rrëmbyer perëndeshës Junona dashurinë e të shoqit, Saturnit. Hakmarrja e pashpirt e Junonës e ktheu Semelën në hi. Njëherësh dëbon prej andej gjithë racën tebane. Motra e tretë Agava udhëhiqej nga fryma hyjnore e dajove, misioni i të cilëve ishte t'i futnin njerëzimit panikun e tmerrin. Vetë Agava epushndjellëse ishte vrasëse e dia burrave.

Zemra e Reas nuk mbante më shumë sa dëgjoi. Shkoi dhe ju lut Kadmit që për hir të Tadesë e dëbuar shtatzënë ta largonte Agavën prej Llykos. Kadmi e hartoi fytyrën si i rënë në një çast krize nuk e fshehu zemërimin pse Llyko i kishte vrarë 5 ushtarët spartanë me të cilët pati ndërtoar Tebën; ashtu siç ndjeu dhimbje për fatin e gruas së dëbuar në ditët e lindjes. Foli si të rënkonte:

- Fatkeqësia nuk vjen vetëm. Në vjen e dyta pas së parës, prit të tretën.

Rea u zverdh. Përderisa Kadmi nuk i dha fjalën e burrit të bënte zap të bijën, Agava mbetej ligësia e Llykos, në mos më shumë. U ngrit të ikte por e ndaloj fjala e fundit e Bimas.

- Unë të besoj, - iu drejtua Kadmit - të pranoj mik e mësonjë. Po në të gënjen mendja të bëhesh Zot,

## Lulet m'i ujit

Dua të vdes duke të pritur,  
Mbuluar e tëra me mall  
Ndoshta do vish për të ujitur  
Lulet, që do të çelin mbi varr!

Ndofta do të ndodhë njëherë,  
Kaq i ri më s' do të jesh,  
Por kur dora të prekë mermerë,  
Nga vdekja ime, jetë do kesh!

## Takim mbi re

Do t'i lutem natës sonte  
Të të sjellë ty në ëndërr,  
Shpirt i vrarë të shikonte  
Veten nuse e ty dhëndër!

Do t'i lutem kësaj nate,  
Një takim të bëjmë mbi re,  
E kur hëna të ndriçonte  
Dritën të kthente nga ne.

Do t'i lutem për një fjalë,  
Si tani të jesh me mua,  
Mos për sonte, ti mor djalë,  
Diellit zjarr i more hua!?

## E huaj

Jepmë qiell një re të bardhë,  
Ti hënë pak dritë për udhëtim  
Se do marr një udhë të largët  
Që ndoshta s' do ketë më kthim!

Do vozis qiellin me not  
Këmbët mos të prekin dhe,  
Do të jemi dyti Don Kishot,  
Si kalë do të kem një re.

Me psherëtimë do shtyj renë,  
"Ylli i shpresës" do më prijë  
Në dorë do të pres rrufenë,  
Renë time mos e shkrijë!

Lënduar jam e po derdh lot,  
Diku, o Zot, më gjej shpëtim,  
E ndiej se s' jam për këtë botë,  
Ndoshta më ke prurë gabim?!

Mos vallë, Zot, më ke dërguar,  
Misionar nga tjetër planet,

## Princeshë e dashuruar

Poezi nga Ornella Torra

Që, kur të shkoj nga jam gatuar,  
Të them, që paska ferr vërtet?!

## Princeshë e dashuruar

Mbeta e vetme nën hije,  
Nën një rrap të vjetër shekullor,  
Shumë shpresonte se do t'vijë  
Kjo zemër që rreh në kraharor!

Hëna shpejt kishte zbritur  
Natën roje për mua mbet,  
Qante vajzën që kish pritur  
Me drit' mbulonte fytyrën e zbehtë!

Mbeta princeshë e dashuruar,  
Duke pritur pa jetë në luadh,  
Kur pa se lotët më shteruan,  
Për mua qau rrap i madh!

## Bukuria

Ma prish mendjen bukuria  
Dy fjalë të ëmbla, në shikim,  
Sa lehtë i more mendtë e mia,  
Me bukurinë si maskim.

Maska shpirtin ta mbulon  
Zemrën gur prej katili  
Lehtë me lajka më mashtron  
Rrëke derdh lot krokodili.

Do vi natën kur ti fle,  
I dashuri im kameleon,  
Që të të shoh ç'fytyrë ke,  
Se mos nesër e ndërro!

## Nëna

Një tufë flokësh nën shami,  
Zbardhur borë nga vetë jeta,  
Mjaltë e zjarr në ata sy,  
Ku burim merr e vërteta.



Ke kaluar dhimbje, halle,  
Nuk ke derdhur asnjë lot,  
Të mirën nga e keqja ndave,  
Pa ty si ferr do ish kjo botë.

Pranë të kam ty moj nënë,  
Se që foshnjë më ke rritur,  
Gëzim, jetë më ke dhënë,  
Ndaj në shpirt të kam skalitur.

E përshkon këtë botë,  
Dashuri natë e ditë  
Veç nga ti moj zemërbardhë,  
Pikon qumësht, buron dritë!

## Do të iki!

Hëna më pret në dritare  
E më thotë "eja me mua",  
Më djegin në shpirt ca zjarre  
S'mund të shkoj dhe pse dua.

Të fluturoj në pafundësi  
Të eci tunel më tunel  
Këtu e vetme s'mund të rri  
Nuk më ngroh më ky diell.

Sytë e vegjël hedh përmbi hënë  
Dua të shkoj fluturimthi mbi të,  
Qiellin për bishti e kam zënë  
S'më mban më këtu asgjë!.

Dua të iki, të largohem,  
E pabesë është kjo botë,  
Diku të paktën të gëzohem,  
Këtu ligësia bën epokë.

Dua të jetoj në Parajsë,  
E të jem vetvetja atje  
Lumturinë ta hedh , ta pres  
Ta kërkoj e prapë ta gjej!

## Poezi nga Maliq TORRA

## Parajsa e vendlindjes

Për vendlindjen s' shuhet malli,  
Tok me ëndrën viset shkel  
Të thërret një shëlg te zalli  
Pret sorkadhja në zabel.

I sodit mbrëmjet e verës  
Një nga një yjet dalin  
Çlodhesh në flladin dehës  
Që lulet në ëndje falin.

Kur buis burimi i kthjellët  
Ku të ngroh rreze e mëngjesit  
Ku baltës nënë i thuhet.

Atje sheh nga zbret ylberi  
Kur pi gji tek ujëvara  
Mrekullohesh mbas një dreri  
Mbas një ketri kur ha arra.

Eh, vendlindja, parajsë e zotit  
Kush mërgoi e nuk ndjeu mall  
Dufi, brenga del nga loti  
Dhe mbas vdekjes prapë të ngjall!

dije se Zoti i Enkelejve është Medauri.

Kadmi i dha përgjigje me një buzëqeshje të lehtë: "Unë nuk jam as Zot as krijesë hyjnore. Veçse kam zotësinë t' i nënshtrhem vullnetit të enkelejve trima e bujarë. Unë di të krijoj, shoh larg dhe shkoj larg. Ja po të pyes ty luftëtar i paepur: a keni ecur ndonjëherë pas lumit tuaj Eordei apo Dril që detit t' i merrni atë që i jepni?". Të tjerë vendas erdhën ta dëgjonin burrin me kokë të mençur. U larguan kur ai shprehu dëshirën e fundit: "Le të bashkojmë shpirtin, Zoti im dhe juaji mbase ka vendosur që fati im të jetë edhe juaji...".

Një karvan me burra mbi kuaj ndiqnin Biman tek- sa kthehej ne qytet. Një suitë me vajza shoqëronin Rean. Nata mbi Enkeli u var si një strehë frike. Malet ndarëse të Eordejt u zhytën në errësirë. Kukuvajkat vajtonin me hidhërim. Atë ditë banditë të panjohur kishin sulmuar, grabitur e vrarë gjer në zemër të qytetit. Mbreti Llyko me të marrë lajmin ishte sulur si dragua por që t'i arrinte ishte njësoj si të kapte ujkun gjallë. Enkelia po përballonte një martirizim të pasosour.

## Agava përçmon shpresat

Dimri erdhi aq i ftohtë sa liqenit i ngrinë buzët akull. Agava mbante shtratin ngrohtë. Nuk ngopej me dashuri, e megjithatë fëmija nuk ngjizi. "Jam një femër mushkë, që nuk pjell", qortoi veten. Njëherësh përçmoi shpresat për të sjellë në jetë trashëgimtarin e fronit mbretëror. Një natë dajo Paniku iu shfaq si fantazmë. "Vdekja e Llykos është vendim hyjnor", i foli rreptë. Në fund të pranverës kur vendosi t' i lëshonte gjarprin, gjithçka erdhi si e kurdisur brenda ditës së tretë, muaji i pestë, viti 1510 në të zbritur. Enkelejtë e rënë në një amulli të thellë shpirtërore dhe të zhgënjyer nga mbreti i tyre u sulmuan papritur.

Ushtri mizore me hungurime bishash bënë kërdrinë në gjithçka të gjallë. Bagëti të egra të rrëmbyera, çobanë e qen të vrarë, lopë e kuaj me veshë të prera,

bimësi e banesa të djegur.

Prej këtij lajmi të kobshëm. Llykos iu err dita me diell. Bashkë me njerëzit që mund ta ndiqnin kalëroi me Agavën në shalë të kalit. Tanimë të gjithë besonin se vdekja e Llykos ishte një formalitet. Nuk u mësua se pre e kujt ai ra sepse të gjithë u vranë. Pas betejës Rea e gjeti trupin e të vëllait me pesë plagë në gjoks e dy thika pas shpine. "Llyko, të paska therur Agava", e vajtoi. Klithma e përsëritur e atij vajtimi sikur formuloi emrin shtesë: Lykothetur ose Llykothis. Rea kërkoi Agavën të hakmerrej, por e ndaloi fatrrëfyeti Thation: "Ashtu si e shkruara hyjnore Semelën e ktheu në hi, kështu edhe Agavën e ktheu në gjarpër. Kur Rea zbuloi qypin Agava ishte aty brenda, gjarpër i ngordhur.

Të nesërmen pas ngjarjes, mortu i kremtua me nderime të mëdha. Mbreti i parë i Enkelejve varrosej duke lënë jashtë emrin e tij më të ri. Kadmit i dërguan skeptrin mbretëror. Shumë shpejt Llykothis u ç'herorizua, e ndërkohë që Kadmi u mitizua. Qenia njerëzore enkelas u bë mbretëria që kërkonte të ndërtonte mbretin. Fjalimi premtues i Kadmit qe fare i shkurtër:

- Nuk erdha t'ju sjell stërmundimet e mia gatuar me të keqen. Dua t'ua largoj të keqen që ju stërmundon.

Rea i bëri vetes pyetjen magjike, nëse Kadmi vinte si shpëtimtar apo mikvrasës. Mori rrugën të gjente kunatën. Sipër, në malin e thatë përmbi shkëmbinj pa një kaproll duke lotuar. Ca më prapa dëgjoi të qarën e një foshnje. Nga që djali i Tadesë kishte lindur i lirë në sy të diellit e quajtën Ilirion.

- Do ta bëjmë mbret, tha Rea. Nuk jemi të racës që durojmë të huajin mbi kokë.

## Gjithçka e thirrur për të mos u harruar

Kadmi me Harmoninë, mirënjohës ndaj enkelejve u prinë t'u japin fytyrën e krijuesit hyjnor. Mirëpo këta, dreqi e mori si gratë fatpadala, ndëshkuan veten

teksa zhatën një tempull të Apollonit. Atëherë zemërimi i Zotit Ares lëshoi mbi ta fatkeqësi më të rënda se çdo mort. Ai fali vetëm të bijën, Harmoninë dhe dhëndrin, duke i shndërruar në gjarpër. Profecia e Kadmit, për të ecur rrugës së lumit Eordei, duket se u realizua 13 breza pas tij. Në pas vitet 1300 p.K enkelejtë zotërojnë gjer në detin Saturium. Shkruhet se mbreti Epidam, pas tij i biri Dyrahu ishin stërnipër të Kadmit nga nëna. Në vitin 1238 plas lufta mes vëllazërisë së Dyrrahut. Ashtu si në vitet 1600 Enkelejtë thirrën Kadmin shpëtimtar, kështu edhe Dyrrahu kërkoi ndihmën e Herkulit. Po tanimë ndryshojnë heronjtë mitikë. I pari është fenikas, i dyti bir pellazgu. Kadmit i dhanë një copë varreze diku pranë lumit Dril. Deri aty e në Enkelinë e lashtë Herkulit i dhanë toka në zotërim.

Legjenda marshon. Në pleqërinë e thellë Kadmi thirri Harmoninë të ngjiznin një djalë me emrin Illyris, prej të cilit do të rridhte emri Iliri. Sipas autorëve antikë, djali i vetëm i Kadmit quhej Polidor. Edhe ky si të motrat nuk pati fat të mbarë. Shkruhet gjithashtu se Iliri është i prejardhur nga Hylli, i biri i Herkulit, i lindur në Korfuz. Ndërkohë që filozofët Apiani dhe Tit Livi thonë jo. Iliri ishte bir i Zotit të fuqishëm, ciklopit Polifen. Ai la gjashtë djem mbretëror dhe tri vasha mbretëresha. Djali i madh quhej Enkel dhe vajza e vogël Desara. Le të besojmë kështu se jemi në truallin tonë.

## Pogradeci mban peng përbindëshin e Secës

Në përfundim të rrëfimit vëmendja na ndriçon Secën. Pas 3500 viteve Kadmi u gjend aty, në varrezën monumentale punuar në pafte bronzi. E shohim të vendosur pas shpinës së Zotit tonë të parë, Medaurit triumfues. Pogradeci mban peng përbindëshin e Sekës. Ashtu i veçuar në lulishten buzë liqenit na duket jo njerëzor. Gjithsesi justifikues. Nëse besojmë që Enkelejtë ishin "njerëz- ngjala", ilirët kishin për totem gjarprin - dragua. Që nga fëmijëria më rri në sy një gjarpër shtëpie që vinte për të mirë e nuk duhej vrarë...

# Isa e Feride Alla, punëtorë e të palodhur



**M**endjenjen e respektit dhe të dashurisë mendova të shkruaj për një familje të nderuar nga Vërriri, njëra prej atyre qindra familjeve të tjera në Mokër, që luftojnë, punojnë e jetojnë aty ku kanë punuar e jetuar prindërit, gjyshërit e stërgjyshërit e tyre. Familja e Isa Allës nga Vërriri, është nga ato familje që di të punojë e të krijojë vlera materiale e shpirtërore, për të jetuar në mënyrë sa më të kulturuar e më të mirë. Dhe këtë gjë kjo familje e ka arritur falë punës së ndershme.

Isai u lind në Vërriri dhe që në moshë të vogël, ndjeu varfërinë e mjerimin. Si mbaroi shërbimin e detyrueshëm ushtarak, u kthye përsëri në fshatin e tij, edhe pse varfëria në ato vite të diktaturës ishte shumë e rëndë. Krijoi familje me bashkëshorten Feriden dhe rriti e edukoi fëmijë të mbarë e punëtorë, që ecën me krenari në gjurmët e prindërve të tyre. Në vitet e vështira të diktaturës, mezi siguroi një punë jashtë fshatit, e cila i sillte më shumë të ardhura se puna e rëndë në kooperativë. Nga viti 1976 – 1992 punoi në gjeologji dhe në miniera si në Katjel, Golik, Velçan, Dunicë, Trebinjë, Skroskë, etj. Vitet e fundit i kaloi në minierën e qymyrgurit në Homezh. Kudo ku ai punoi

në këta sektorë të rëndësishëm industrisë sonë, tregoi aftësi, profesionalizëm në punë, ndershmëri. Gjithmonë i shkathët, i palodhur, i ndërgjegjshëm në kryerjen e detyrave që i ngarkoheshin, duke krijuar e fituar respektin e kolegëve, shokëve e miqve të tij. Për punë të mirë ka marrë dhjetëra vlerësime, edhe pse ato ishin thjeshtë vlerësime morale, fletë-lavdërimi, që nga ndërmarrja e deri tek ato të dhëna nga Ministria e Industrisë dhe Minierave (që flasin më së miri për punën dhe përkushtimin e tij). Isai është dekoruar nga Kuvendi i Shqipërisë për punë të mirë e cilësi.

Me ardhjen e demokracisë Isai kthehet në Vërriri. Në fund të fshatit, në krah të rrugës automobilistike, ndërtoi fillimisht një lokal të vogël tregtie. Më vonë e zgjeroi atë për organizimin e festave, dasmave e të tjera, një lokal me kapacitet deri në 150 vetë. Në punë e sipër Isai i lindi ide të reja. Me të ardhurat që siguroi nga puna e fëmijëve në emigracion, Rolandat dhe Mirjanit, të dy shumë punëtorë, pasi e kanë të trashëguar në gen, dashurinë për punën, si të thuash e kanë në gjak punën, hapën një pikë servisi, një pikë karburanti e më pas edhe shërbime të tjera për fshatin dhe gjithë makinat e zonës. Së

bashku, prindër e fëmijë, ata punojnë edhe sot me profesionalizëm e me ndershmëri në shërbim të njerëzve. Rritja më e madhe është jo vetëm ana financiare e kënaqshme, por sepse ata kanë siguruar punën pranë familjes, të gjithë së bashku.

Vetë Isai është shumë i kënaqur nga kjo dhe sekretin e suksesit, në lidhje me punën dhe njerëzit ai e shpreh vetë: “Të kesh durim, të jesh i kujdesshëm e me zemër të madhe, i respektueshëm në pritje e në përcjelljen e njerëzve”.

Në vitin 2010, në muajt shkurt – mars pasoi një dëm i madh natyror, dhe rrëshqiti, si pasojë e shirave të shumta dhe toka ku ka ndërtuar objektet e shërbimit Isai pësoi të çara, por edhe pse dëmet ishin shumë të madha, Isai nuk e prishi gjakun. Diku në një vend tjetër ai do të ndërtojë një lokal edhe më të madh, edhe më të bukur. Isain dhe gjithë familjen e tij e karakterizon optimizmi dhe puna e tyre. Ata janë mjeshtër për hapjen e puseve të ujit të pijshëm. Kanë hapur me dhjetëra puse në fshat e në fshatra të tjerë, pasi siç dihet, Vërriri gjithmonë ka vuajtur për ujë. Por tani në Vërriri çdo shtëpi e ka zgjidhur problemin e ujit të pijshëm, dikush me puse e dikush me burime natyrore.

Por Isai nuk le pas dore as punët e bujqësisë. Ata janë edhe fermerë të dalluar, sidomos në rendimentet e larta të frutikuturës e në vreshtari. Kanë shumë rrënjë qershie prej të cilave sigurojnë goxha të ardhura, shto edhe grurin, misrin e vreshtat, pra është me të vërtetë një shtëpi e organizuar mirë dhe shembull i jetesës në Vërriri e gjithë Mokrën mbarë. Dhe shembuj të tillë ka edhe të tjerë në këtë fshat. Bashkëfshatarët e Isait, si Agron Sula, Besnik Sula, Saip Alla, Dehar Leka, Njazi Alla etj, të gjithë nga Vërriri, lartësojnë emrin e këtij fshati që jetojnë me djersën dhe punën e tyre të ndershme, në vendlindjen e të parëve të tyre.

Nëpërmjet këtij shkrimi i uroj Isait dhe familjes punë të mbarë e shëndet, në jetën e tyre të përditshme, begati e lumturi paçin brez pas brezi!

**Sami LEKA**

**URIM: Redaksia e gazetës “Mokra” e uron nga zemra Isain për martesën e djalit të tij, të trashëgoet e me jetë të lumtur!”**



## E paharruara nënë Xhemile Haxhi Leka

**M**ë 20 mars 2010 u nda nga jeta, në moshën 90-vjeçare, nënë Xhemilja nga fshati Slatinë, një nënë e dashur dhe një grua e pamposhtur, një grua me të cilën jeta, ndonëse u tregua bujarë në vite, nuk u tregua e tillë në cilësinë e saj, përkundrazi u tregua e egër, por që falë zotit, ajo ditë ta përballojë atë me forcë, me kurajë e me dashuri të pakufishme! Xhemile Haxhi Leka u lind në fshatin Slatinë më 03.10.1920, nga një familje me tradita atdhetare të Mokrës. Xhemilja ishte bija e Haxhiut, motra e vëllezërve Hysen, Murat e Ali Isufi. U martua me të ndjerin Bari Leka po nga Slatina. Kjo familje ishte e nderuar, punëtoare e me ndjenja patriotike. Në këtë familje u lindën 11 fëmijë Muhameri, Nafireti, Shefia, Ilmiu, Zyraja, Raifi, Neslia, Sadeja, Njazi, Syrjai, Ismeti. Për fat të keq, tre nga këta fëmijë nuk jetojnë më Neslia, Sadeja e Ismeti. Dhe nuk ka dhimbje e dramë më të madhe për një nënë sesa të shohësh të ikin para fëmijët e saj!

Nënë Xhemilja jetoi dhe punoi në një familje të madhe me mbi 20 vetë. Jo bënte punët e shtëpisë dhe mbante gjithë barrën e saj. Ishte një punëtoare e madhe, gjithnjë e palodhur. Gjatë Luftës për çlirimin e vendit priti e gatoi ushqime për partizanët që luftonin për liri, edhe pse ishte në kushte shumë të vështira ekonomike. Kunati i saj, Gani Leka, ra dëshmor për çlirimin e atdheut.

Jo ishte një grua e nderuar dhe e respektuar në Slatinë, një grua me zemër të madhe e që kurrë nuk bënte fjalë e nuk i binte kujt në qafë. Gëzonte respektin e gjithë zonës, jo vetëm në Slatinë, por edhe në Debrovë, në Senisht, Stravaj, Vërriri e në gjithë Mokrën mbarë tek ata që e njihnin, e donin dhe e respektonin!

Por jo çdo gjë shkon mirë në këtë jetë. Në moshën e pleqërisë, në një kohë të shkurtër, brenda pak vitesh, në shtëpinë e saj ajo përcolli katër vdekje tragjike, të cilat e tronditën rëndë. Megjithatë nënë Xhemilja gjeti forca dhe e përballoi dhimbjen. Në ato çaste të vështira si nënë shqiptare e si nënë mokrare, tronditjen e thellë e ktheu në forcë, diti të mbrojë fëmijët, nipërit e mbesat, duke u vënë atyre kurajë e shpresë. Tragjeditë që pa ajo ishin nga më tronditëset dhe rrëqethëset për familjen e saj, për të afërmit, për miqtë e asaj shtëpie të nderuar. Të tilla tragjedi as hasmit me osia pafsh!

Nënë Xhemilja ishte shembull i fisnikërisë, ishte një nënë zemërgjerë dhe e dashur për të gjithë, sidomos me fëmijët, me nipërit e mbesat të cilët i donte dhe e donin pa masë.

Më 20 mars të këtij viti, në prag të 90-vjetorit të saj, e lodhur nga hallet, nga jeta që u tregua e pamëshirshme, ajo shkoj e përcjellë me dhimbje dhe dashuri të pakufishme të djemve, vajzave, nipërve dhe mbesave, nga miqtë, e të afërmit, nga bashkëfshatarët e saj, nga të gjithë ata që e deshën e i deshi e që do ta kujtojnë gjithmonë me nderim e respekt. Duke i shprehur ngushëllimet tona të sinqerta familjes për humbjen e nënës së tyre të dashur, njëherësh u urojmë sa më shumë gëzime e lumturi në familje, të rojnë e ta kujtojnë brez pas brezi!

**Sami LEKA**

Nga Halit ÇELA

## DISA KUJTIME TË VEÇANTA

**N**ë Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare më futi xhaxhai im Alush Çela, cili ishte partizan në çetën partizane rezervë të Liko Gjonës, në fshatin Laktesh. Aksioni i parë është me çetën partizane të Mokrës, të drejtuar nga Reshit Çollaku, si komandant kompanie kam pasur Qamil Musaraj, nga fshati Losnik.

Pas kësaj u caktua në brigadën e IV-S, me komisar Stefan Dishnica. Brigada e IV-S luftoi në Voskopojë, Korçë, Mokër, Mirditë, Pukë, Malësia e Madhe, Kukës, Dibër të Madhe e tjerë.

Me këtë brigadë kam pasur edhe djem të tjerë nga fshati Velçan, si Serjan Çelën, Tahir Hajdar Shuli, Sabri Beqir Biba, Sefkë Qerim Biba, Ramadan Cane Lufo, Kamber Maliq Hyko, Rushan Idriz Hyko dhe Ahmet Gjonën nga fshati Laktesh.

Më bënë komandant toge, shokët më dëgjonin, isha shumë i ri. Një natë ishim në fshatin Orosh, të Mirditës, në një familje të mirë. Një partizan më informoi se partizanët nga Velçani i Mokrës, na kanë turpëruar, se kishin

ngrënë mish derri. Për, këtë në togë kisha një partizan nga Struga, Sabri e quanin, kishte punuar si hoxhë. I thashë në luftë lejohet të haet mish i derrit! hoxha me kujdes u përgjigj “Po në luftë ushtrisë i lejohet të hajë mish derri”. Kjo përgjigje i qetësoi partizanët e tjerë.

U futëm në Mirditë, në një shtëpi, të madhe të pastër. Pyetja e parë që bëri i zoti i shtëpisë ishte “e hani mishin e derrit”. Përgjigjia ishte pozitive, dhe filloj të gatuj. Edhe kavajasi Beqir Hajdini, nga Luzi i Madh, Halit Meti nga Luzi i Vogël, Musa Meçi nga Domja dhe një partizan nga Synej, u pëlqeu mishin i derrit dhe porositen prapë.

I zoti i shtëpisë, një burrë i zoti, më pyeti mua se nga isha. Iu përgjigja se isha nga fshati Velçan i Mokrës, me një herë pyeti. Po Alush Çelën ai i sipërmi është gjallë. I thashë se e vranë gjermanët me dy djemtë në qershor 1944. Atë e kam pasur mik, në Pogradec kam qënë xhandar dhjetë vjet në kohën e Zogut. Me pushtimin nga Italia të Shqipërisë u largova nga xhandarmëria.

Lufta 3-4 e qershorit 1944, në Katjel, ishte e vështirë, përballuan forca të shumta gjermano-balliste. Aty u plagos edhe Maliq Rapshe nga fshati Velçan, u vra një vajzë partizane. Pas qëndresës kompania e jonë me zëvendës komisar Dishnicën u tërhoq në mbrëmje në drejtim të Radokalit. Në kolonë shikoja një burrë rreth 60 vjeç, ai ectë si xhaxhai im Alush Çela. Plaku pyeste se e njihni një partizan të vogël Halit Çela. Por përgjigje nuk i kthenin. Ai mori takim me zëvendës komisar Dishnicën, i cili më gjeti mua. Shkova e përqafova biseduam pak. Dëshira e tij ishte që unë të shkoja 2-3 ditë në shtëpi në Velçan dhe pastaj të shkoja me forcat partizane ku të ishin. Por zëvendës komisar, për këtë i tha që të pyesim Halitin, u ktheva përgjigje se do të vijë në Velçan pas 3-4 ditësh. Ky ishte takimi i fundit me xhaxhain tim Alush Çela, nuk u takuam më tërë jetën. Atij ia ndërprej jetën forcat gjermane dhe tradhëtarët më 10 qershor 1944, në malin e Gjëmthit.

(vijon nga faqja 3)

U ngrita ika si i zënë në faj për veset që më mungonin. Më vonë, kur fillova cigaren, rakinë dhe ca punë të tjera burrash e kuptova shumë mirë trishtimin e plakut të urtë, atë ditë vjeshte të vonë nën hijen e kumbullës në Sanakozë. Dajo Kajani më dha leksionin e parë të jetës, pas profesorëve të Tiranës që më kishin lënë mangët në formimin tim. Nga ajo ditë ndryshuan shumë gjëra në karakterin e sjelljen tek unë.

-Ke të drejtë ta vlerësosh xha Kajanë, se vërtet ata bartnin traditën zgjuarsinë e popullit dhe e trasetonin atë pa "para". Edhe unë do shfrytëzoj këtë bisedë për të kujtuar disa nga rrëfimet e tij që, megjithëse kanë kaluar mbi 30 vjet, i ruaj të freskëta në kujtesë.

Unë, si specialist blegtorie, e kisha të lidhur punën me Sankosën, atë vend blegtoral, ku banonte xha Kajani me familjen dhe unë e takoja vazhdimisht. Madje i shkonim shpesh në shtëpi me gjithë Tomor Spahiun veterinerin, për arsye se atij i bëhej qejfi kur i vinin miq, por edhe se ai ishte blegtor veteran e, den baba den, blektor. Gjatë atyre muajve të verës ne e angazhoni të kujdesej me disa deshë të rracës. Mua xha Kajani, që atëherë ishte 80 vjeç, më thoshte: "Ty "doktor" të dua, se je nga fisi i Pihonajve të Llëngës, nga ai fis i papa Kostandinit që ne na kishte mik shtëpie, Ai ishte burrë i mençur e trim. Atij i peshonte e i dëgjohesh fjalat në tërë Mokrën, Gorën e Shpatin. Dhe mbante mend dhe fjalët e një kënge që këndohej për të. (Shënim: Teksin e këngës origjinal sot e ka zoti Llazi Tona, të gjetur të shkruar në gjuhën italiane nga Antonio Baldaci, studiues i shek XIX, i cili, për 25 vjet rresht, eksploroj, shqipërinë, Mokrën e kurorën e Valamarës, eksploroj e identifikoi mbi 300 bimë medicinale. Në botimin e tij të vitit 1895 ai thotë: "Një shtet i fuqishëm, do ta kishte shpallur këtë vend, "Park Kombëtar Medicinal". Në këtë botim ai shkruan se ky popull nuk jeton dot pa armë, pa pushkën. Ka qenë kryeministri italian me origjinë shqiptare Kripsi, që financoi për një kohë të gjatë këtë ekspeditë me qëllime njohtëse për Shqipërinë).


Në një takim tjetër me xha Kajanë, së bashku me Kiço Beçkën atëherë ai, ishte me detyrë kryeveteriner në rreth. Si u përshëndoshëm e këmbëzëm nga një cigare duhan, doktori i tha xha Kajanë, mbase ai i ankohej për pleqërinë: "Pleqëria qenka shumë e keqe, aq sa edhe qeni kur të sheh, ngrihet më këmbë e të leh!" Doktor Beçka i tha: "Xha Kajan, më thuaj, ç'merak të ka ngelur nga kjo botë?". "Më vjen keq, për atë ujë e pastër e të ftohtë të burimeve që shkon kot, duke gurgulluar, shkon e derdhet në det, kur ka miliona njerëz në këtë botë, që iu piqet, iu zhuritet goja, iu zë buza shirit për një gotë a buki me ujë të ftohtë burimi!

Keq më vjen, o doktor, e për ata ahet shekullorë që rrezohen e kalben atje në pyll, kur janë me mijëra fëmijë, pleq, të sëmurë që vdesin nga të ftohtit në këtë botë. Dhe së fundi më vjen keq për ato gratë faqekeqe, të mbetura të veja, që shkojnë xhabana nga kjo botë!"

E falënderuam xha Kajanë, duke marrë me vete atë "merak" rrëfim të fundit të tij, që ne të gjallët po shkruajmë e rrëfejme me gojën e atyre burrave dikur si ne të gjallë.

Burra si xha Kajani, Seffa i Dunicës, Qamil Spahi, Gani Xhaja, Teki Agolli në Dunicë, xha Nurja i Baçllarëve të Çezmës, xha Demiri, xha Bakiu, xha Limja i Kalivaçit, xha Bektashi i Proptishtit, Hamit Kroi i Selcës, Thanas Macolli e Miti Spirollari nga Pleshishti, xha Pasko Gegpriftit, Maros e Fanës nga Potgozhani e shumë të tjerë u kërkoj ndjesë, janë gurra popullore e kësaj krahine janë tabani, themeli i traditës e mençurisë popullore. Që tregohen e ruhen edhe sot atje në Mokër e Gorë. I dashur shoku e mik i Istref, besoj të kesh dëgjuar e ti vetë fjalë që venë në "dyshim" gjenezën tënde "atërore" dhe se nëna juaj ka qenë simbol i bukurisë së një vashë, ashtu është quajtur ajo në atë kohë, "Nusja më e Bukur" e tërë Nahijes së Mokrës e më gjërë! Cili është komentit juaj, në se mundesh të thuash diçka, na thuaj, të lutem, meqenëse është ky rast?

-Thashethemnajën për origjinën time italiane e ka përhapur mjeshtërisht miku



# Nusja e bukur

E panjohura "mistike" në jetën e shkrimtarit Istref Haxhillari!

ynë i përbashkët, Ismail Xhaja, natyrisht një shaka jo dhe aq e pafajshme. Aq mirë e ka përpunuar këtë gojëdhënë saqë, edhe mua më duket si e vërtetë, sikur unë kam rrënjë italian, sipas Ismailit, që dhe ai behohet se gjithçka është e vërtetë si drita e diellit, se nëna ime ka qenë e bukur. Në kohën e luftës italo-greke, reparti italian ka qenë i dislokuar në Dunicë, ai komandohej nga një kapiten elegant të cilit i kish rënë në sy hijeshia e nënës. Lufta mbaroj dhe ai iku pa mundur të këmbëjë asnjë fjalë. Në vitin 1948 kapiteni erdhi të mblidhte kockat e ushtarëve të vrarë. Aty na i paska rënë ndër mënd, "Nusja e bukur" dhe ëndrra që thuri dikur. Kështu pas ikjes së tij Linda unë. Po t'i besojmë shakasë, unë qenkam fëmijë ilegal me baba italian. Për fat të keq, këtë histori e kam dëgjuar vonë, tashmë nëna nuk jeton dhe unë s'kam asnjë mundësi ta vërtetoj.

-I dashur shoku im Istref, mbase duhet t'ju kërkoj ndjesë për këtë pyetje pak sa intime në jetën e të ndjerës nënës tuaj të dashur, por ndodh shpesh me sa di unë, që fëmija shumë gjëra nga jeta e prindërve i merr vesh i fundit. Këtë histori të padëgjuar dashurie e kam dëgjuar edhe unë, por paksa më ndryshe dhe jo nga goja e shokut tonë të përbashkët Ismail Xhaja, por nga persona që e kishin jetuar këtë histori. Në se më lejoni unë do ta rrëfej me "vërtetësi" këtë histori të çuditshme dashurie që mbase duhet të bëhet objekt i një studimi shkencor a mistik, sa tokësor e qiellor!

Ja dhe rrëfimi im: "Nusja e bukur"  
Kjo ndodhi dashurie tregohet se ka ndodhur në verën e vitit 1940, në kohën e luftës italo-greke, ku ushtria italiane ishte dislokuar në pjesën veri-perëndimore të malit perëndi "Kozici", kështu e quaj unë atë në fshatin Dragonë apo Dunicë, dhe ushtria greke ishte dislokuar në krahun e mëngjër poshtë Gurit të Kamjes në Onat e Nicë. Garizoni Italian i vendosur në Dragonë, komandohej nga një Kapiten i gradës së parë, i quajtur Xhuzepë, një ushtarak karriere i pashëm, shumë i zoti e me autoritet. Kishte

mbaruar akademinë ushtarake në Romë e ishte diplomuar për artilier që po ta llogariste ai, predhat e topit i bënte, "kosh" edhe në kazanët e gatimit të kampit armik.

Ky komandant kish zgjedhur për banim një ndërtesë në lagjen e Diellit e cila kish qëlluar të ishte pranë shtëpisë të një vajze të porsamartuar, një nuseje shumë të bukur që dhe burri i saj ishte i mobilizuar nënarmë, diku nga veriu i vendit. Kjo komshie, kjo fqinjë e bukur ia prishi qetësinë dhe ai u dashurua marrëzisht pas saj. Dhe bëri ç'ishte e mundur që të krijonte miqësi me atë familje, duke paguar për disa qetime të traditës dhe larje këmishash e hekurosje teshash nga duart e saj dhe pas kësaj miqësie, guxoi të shkonte më tej, t'i thoshte "Ti amo" (Të dua!). "Dua të vish të jetosh me mua në Milano", gjë që për atë italian ishte mbase normale dhe besoj ai, se ajo, nuk do ta refuzonte këtë shans, fat për një jetë më të mirë që po i afrohej asaj. Por nuk ndodhi kështu, ajo "Nusja e bukur" i buzëqeshi e falënderoi për atë vlerësim e dashuri të zjarrtë, por i tha prerë se ajo, nuk mund ta ndërronte më fatin e saj, për hir të zakoneve të vendit e fjalës e besës së dhënë burrit që kish ndenjtur, një javë martuar. Ky ushtarak i dashuruar ishte dhe njeri me besim të madh tek Zoti. Prandaj dhe me dy ordinancat e tij në shoqërinë e udhërrëfyesit, kalëruar shkojnë në Manastirin e shën Marenës në mëngjesin e një të diele, mbasi atij Xhuzepes i ish shfaqur në ëndërr, vetë Zonja Marenë dhe diçka e kishte këshilluar ajo, prandaj ai shkoi atje, pasi u

fal e iu lut Zonjës Marënë, dëgjoi edhe meshën e lutur atje, për atë ditë, për besimtarët e saj të shumtë, më pas ai shkoi në vend burimin e saj, atje tek Najazma, ku mbushi një enë me ujë që nuk prishet. Shkoi dhe mori gur tek banesa e saj dhe një lloj bari që rritet atje, "Bar zëmëre" dhe më pas u kthye i lehtësuar në Dragonë.

Në banesën e tij, që ndodhej pranë asaj të së dashurës të tij të zemrës të munguar, që kish rënë në dashuri me shikim të parë, dhe nuk mundi të dashurohej fizikisht kurrë. Dhe i këndonte ai asaj: "Vogëlushe ti se di, ç'është dashuria! Se ke provuar ç'ke dashuruar. Tashti ky ushtarak karriere, ndihej i dështuar në këtë dashuri, prandaj vendosi të eksplorojë gjithë dijet e arritjet e shkencës në gjenetikë që të realizonte lënen e një pasardhësi, shëmbëlltyrën e tij. Ai, aplikoi idenë e klonimit, studioi ligjësitë në krijesat hemafrodite dhe u thellua tek fenomeni i Partogjenezës tek kolonia e Bletëve, ku Mbretëresha në qoftë se për shkaqe të ndryshme nuk fekondohet, ajo pjell vezë të cilat sjellin në jetë, vetëm krijesa në gjininë mashkullore. Më pas ai përgatiti një solucion më përbërjen e një sasi prej tre elementësh "vere cilësore" në të cilën shtoi një porcion lëngu të prodhuar nga e zjera e atij "bari të zëmërës" në atë ujë të shenjtëruar dhe i shtoi një sasi 10 cc gjak nga zemra e shpirti i tij i dashuruar. Kjo përbërje me fuqi sa mistike dhe enigmatike u tapos, në mënyrë hermetike në atë shishe shampanje italiane dhe më pas i qetësuar e i lehtësuar, gjeti rastin ta takojë atë "nusen e re" dhe t'i kërkojë ta pranojë këtë dhuratë si simbol të asaj dashurie, që vetëm ata që e kanë përjetuar, kanë të drejtë, besoj ta përshkruajë. Këtë "dhuratën" ajo me mirësjellje e pranoi dhe ai, ndjehej shumë i lumturuar, mundi t'i rrembejë asaj, një puthje të zjarrtë dashurie me hirin a pahirin e saj! Kjo e vetmja puthje, është "fotografuar" nga sytë e një të vetmit dëshmitar okular, i cili pas 40 vjet të mbajtur të burgosur, të kyçur në shpirtin e tij, sa ai ishte gjallë dhe se dinte se unë isha stërnip prifti, ma ka përcjellë si rrëfim vetëm mua, me kusht që të mos e bëj publik në të gjallë të tija. Besoj t'ia kem përmbushur e unë atij, ruajtjen e sekretit, të atij rrëfimit.

Ajo përzierje tashmë, do kishte fuqi çuditëbërëse, efekt të padëgjuar tek përdoruesja e saj, kjo përzierje e ndodhur në këtë enë, tashmë duhej të vendosej diku në një vend të qetë e të sigurtë, sëndyku i pajës së saj dhe të nxirrej e përdoret pas shtatë vjetësh. Në etiketën e vendosur asaj shisheje, ishin të shkruara disa gërma latine, që të deshifruara shqip, domethënia ishte kjo. Këto gërma të parashkruara, paratregonin, sjelljen në jetë të dikujt ndryshe, të ngjashëm me atë të ardhjes të Jesu Krishit në jetë, këtu rëzë Malit të Perëndive të lashta, domethënë historia e Italianit që do sillte në jetë dikë me nënë si Zonja Mari, emri i asaj zonjë fillon me gërmën S, sipas tre përbërësve të kësaj ene, fëmija që do lindë, do jetë me "fat" dhe do t'ju sjellë fat e mirësi dhe për shumë të tjerë. I + S + Tre + F!

Dhe kështu ka ndodhur, pas përdorimit të atij solucionit me aftësi çuditëbërëse, shtatë vjet më pas do vijë në jetë tre fëmijë tri të gjinisë meshkuj sikurse ishte e para thënë atje në atë manastirit të krahinës me historira e të tjera çuditëbërëse, plus partogjenezën.

Çuditërisht, ju jeni në një farë mënyre si i "ringjallur" ai oficeri i karrierës, i dashuruar marrëzisht me nënën tënde, atë zonjë të nderuar, dikur, "Nusja më e bukur" e tërë Mokrës, trimëreshë!

Pogradec 6. 06. 2010

**ISTREF HAXHILLARI**

ENDRRAT KRYQËZOJNË KOHËN

**ISTREF HAXHILLARI PROMOVON ENDRRAT NË DURRËS**

Me ftesë të degës së shkrimtarëve të Durrësit, është promovuar në këtë qytet, në ambientet e librarisë "Blue stars", më 17 qershor, novela e fundit e Istref Haxhillarit "Endrrat kryqëzojnë kohën". Mërnin pjesë shkrimtarë, kolegë, nxënës e miq të shkrimtarit. Fatime Kulli, Fatmir Musai, Bujar Balliuu, Rajmonda Moisiu, Kozeta Zavalani, Shpëtim Myshketa, Mimoza Erebara, Vera Vasia, Pëllumb Zade etj, analizuian vlerat e librit dhe ecurinë e shkëlqyer të autorit në letërsi, jo vetëm me tituj por edhe me cilësi e çmime, kombëtare e ndërkombëtare. Në fund autori falenderoi të pranishmit dhe organizatorët si dhe shpalosi procesin e tij krijues.

# PROMOVOHET LIBRI ME POEZI "DHE DY PIKLA UJË BËJNË DASHURI..."

NJE LIBER I SINGERTE, EMOCIONUES PER JETEN DHE DASHURINE

Në një nga sallat e Muzeut Ko mbëtar Tiranë, më datën 29 maj 2010, u bë promovimi i librit me poezi, "Dhe dy pikla ujë bëjnë dashuri" të autores Mimoza VASKU.

Pjesëmarrësit në këtë promovim ishin të njohur me njëri-tjetrin, midis tyre figura të njohura në fusha të ndryshme, por dashamirës të librit, të cilët shpaleshën me sinqeritet, respekt e përzemërsi cilësitë dhe vlerat e poezive në vëllimin më të fundit të autores.

Diskutimin kryesor e mbajti studiuesi dhe poeti Mevlud Buci, i cili vuri në dukje vlerat reale të poezisë së saj, parqitjen e jetësore në poezi, si dhe pasqyrimin me sinqeritet si të momenteve pozitive, ashtu dhe negative të jetës nëpërmjet gjuhës artistike dhe përdorimit të figurave të ndryshme letrare. Ja si shprehet ai midis rreshtash gjatë diskutimit: "Aludimet me jetën, me fatin, me njerëzit, mallin, me dukuritë, me dashurinë, me pyetjet, me valët e dashurisë, me retorikën për tradhtinë, me rrugët e vuajtjeve, me lule e trëndafila, me atë sesi merr veten përdore, sesi portretizon filozofikisht dhe artistikisht "Monalizin e lagjes", sesi gdhend vargjet himn për urrejtjen dhe dashurinë, për shpirtin e arratisur, pasanikun, endacakun, kujtimet, lavdinë e burrave, ditën e fundit, rrugëve të Shkupit, qiriun, pasurinë, fallxhoren, braktisjen e shpirtit, vuajtjen, buzëqeshjen e ashpër, mallkimi, vera e kuqe, një mal përse, mos ma prek lotin, Sofra e Skënderbeut, Strugës, dashurinë kudo e kam kërkuar, Qafë-Thana e plot e plot të tjera përbëjnë një gjerdan të artë poetik, një ylber të rrallë bukurie, dashurie e fisnikërie".

Promovimi nuk u drejtua në mënyrë akademike, siç jemi mësuar shpesh, por diskutuesit: Ali Coka, Ferit Fixha, Zabit Cuku, Fatmir Hoxha, Haki Balliu, Pandi Popovski, Fatrie Alimehmeti, Flori Slatina, Shpëtim Bozha, Fuat Memeli, Luan Ahmetaj, Kujtim Boriçi, Petrit Mënaj etj, e morën fjalën pa prezantim, me dëshirë për të bashkëbiseduar e replikuar, ku gjatë fjalëve të tyre, folën natyrshëm për vlerat e poezive dhe të gjithë librit. Nuk mungoi humori dhe citimi i vargjeve më të bukura të poezive të vëllimit të Mimozës. Midis diskutimeve e bashkëbisedimeve miqësore u recituan me ndjenjë edhe vargje të zgjedhura prej vëllimit, nga znjsh. Fatjona Geci, të cilat së bashku me diskutimet e çiltra e të hapura i dhanë takimit vlerat e një shoë të vërtetë.

Haki Balliu, si krahinor i Mimozës dhe njohës i mirë i Mokrës dhe krahinave përreth, autori i disa botimeve për Pelionin në Mokër, theksoi se: "Krahina e Mokrës ka pasur trimëresha me pushkë, por Mimoza Vasku është trimëresha me penë. Fshati Rrajcë, i lindjes së Mimozës, ka nxjerrë figura dhe trima dhe po nxjerr të tjerë. Ishte Merko Bozha i cili liroi 100 burrat e kazasë Ohrit me një fjalë të tij para gjykatësve turq: "Ose na liro të gjithëve ose as mua"..."

Me respekt dhe emocion këtë promovim e përshëndeti dhe deputeti i zonës z. Rrahim Çota, i cili vlerësoi realisht punën e poetes, ashtu dhe vlerat e librit. Ai duke i uruar poetes arritjet më të mëdha në botimet e ardhshme e përkrahu dhe për angazhimin e saj në politikë.

Mimoza, siç është përmendur edhe më lart, shkruan për çdo gjë që e ngacmon. Ajo nuk ka nguruar të shkruaj edhe për Qafë-Thana, Domosdovën, Sofrën e Skënderbeut etj...

...Ndër shekuj mbi ty, Qafë-Thana  
Pushuesit ushtri të shumta prunë,  
Por mbi kreshtat majë qiell,



Autoria: Mimoza VASKU  
Botoi: Shtëpia botuese "Emal"  
Lloji: Poezi  
Faqe: 207  
Çmimi: 600 lekë

Flamurin e tyre kurrë se vunë.

Ti, ke lindur djem trima me kohë e sot,  
Emri yt lartësohet çdo ditë anembanë.  
Çdokush që largohet, e nxjerr një pikë lot,  
Për të varfren dhe të bukurën Qafë-Thana.  
Po kaq bukur i thur lavde edhe vajzës  
domosdovare, dhe ja si vargëzon ajo.

...E pashoqja Domosdovë!  
Jam bredharak i dashurisë,  
I kthyer në himn deri në dhimbje,  
Njeriut dhe bukurisë.

Çuditë! Janë vajza apo zana.  
Vajza që unë dua, është hëna.  
Jam i lumtur që i zbulova,  
Yjet që s'i lind më nëna.

Për promovimin e këtij libri Mimozën e nderuan me pjesëmarrjen e tyre edhe bashkëfshatarët e saj që jetijnë në Tiranë, intelektualët; Xhevat Hana, Hetem Rira, Flori Karaj, Ali Coka, Zabit Çuku, Drita Rira, Edmond Rira, Shpëtim Bozha etj. Po ashtu Mimozën e nderuan edhe çifti artist nga Librazhdi: Hatixhe dhe Arif Lushi.

Në vazhdim, një koktej i pasur i dha promovimit një intimitet të veçantë ku të pranishmit biseduan dhe diskutuan me njëri-tjetrin në grupe-grupe, duke ngritur dolla e kënduar këngë por edhe duke i fiksuar momentet e bukura të takimit si kujtim në fotoaparate, që dukeshin kudo nëpër sallë.

"Unë jam vazhduese e brezit të intelektualëve të Rrajcës" - u përgjigj Mimoza fjalëve të mira të pjesëmarrësve gjatë koktejit dhe përmendi me radhë emrat e intelektualëve si; Sali Bogdani, Sami Bogdani, Sadi Halili, Fatmir Halili, Xhe-

vat Hana, Enver Cuku, Flori Karaj, Xhevat Rira, Bashkim Bushi, Pasho Hoxha, Ali Coka, Etem Rira, Selman Coka, Ahmet Collaku, Mevlud Hallidri, Tefik Bogdani, Musa Halili, Selaudin Bogdani, Shpëtim Bozha, Ahmet Stojna, Neim Mala etj. "Këtyre intelektualëve ua njoh vlerat, punët e mira që kanë bërë" - tha Mimoza - "Por unë vetëm dua që të eci në rrugën e tyre për të ndryshuar diçka në të mirë të zhvillimit dhe përparimit dhe emancipimit të shoqërisë".

Por ky promovim nuk mbaroi në Tiranë, por vazhdoi edhe në Strugë, në kuadrin e panairit "Karvani i librit shqip" që zhvillohet në trojet shqiptare në Maqedoni. Në prani të një auditori të zgjedhur shkrimtarësh dhe intelektualësh në Universitetin INTERNACIONAL të Strugës, më 2 qershor 2010, vazhdoi promovimi i këtij libri, nën kujdesin e Komunës së Strugës dhe drejtuesve të panairit të librit.

Ashtu si në Tiranë edhe në Strugë, u fol për vlerat e poezive të Mimozës, u thanë fjalë të mira për sinqeritetin e poezive, për krijimin sipas ritmit dhe shqetësimeve të vetë jetës. Por në Strugë krahas vlerave të poezisë së librit u fol edhe për një bashkëpunim midis poetëve të shqiptarëve të Maqedonisë dhe Shqipërisë. Kryetari i Komunës së Strugës, z. Ramiz Merko tha fjalë të mira për aktivitetin, por dhe për bashkëpunimin me vendet kufitare si me Rrajcën, Përrenjasin, Librazhdin e Pogradecin, etj. "Strugën me qytetet Pogradec, Përrenjas e Librazhd, -tha z. Merko, e lidhin histori të forta marrëdhëniesh në të gjitha aspektet. Këto qytete ngjajnë shumë me njëra-tjetrën në drejtim të dokeve, zakoneve, traditave, të cilat tani me shembjen e kufijve, po ndikojnë në forcimin e lidhjeve dhe miqësive të reja, për të cilat duhet të punojmë më shumë në intelektualët e të dy krahëve të këtij kufiri imagjinar.

Edhe në Strugë, me një auditor intelektualësh, mbas diskutantëve e mori fjalën autorja me këto fjalë;

-Jam tepër e emocionuar për gjithë këto fjalë të mira. Nëse të gjitha u thanë, më mbetet vetëm të uroj organizatorin e "Karvani i librit shqip", z. Sevim Ahmeti, i cili përzgjedhi pikërisht librin tim për promovim këtu në Strugë, përshëndes të nderuarin kryetar të Komunës Strugë, z. Ramiz Merko, i cili na solli në këtë ambient edukimi, (Universiteti Internacional) për tu thënë disa fjalë rreth librit tim dhe gjithashtu ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrjen.

Në fund autorja dhuroi librin me autograf dhe më pas vijoi kokteji në natyrë, të mundësuar nga vetë Komuna Strugë.

Zabit CUKU

## LAPIDARI BUZË LIQENIT

Nga Skënder I.TUPJA

Sa herë merr rrugën e Korçës dhe makina lë pas Qafën e Thanës, sjell në mendje një pikë të bregut të liqenit kaltërosh. Dhe ja pas një copë rruge, para meje del ai rrip i ngushtë fushe, rrethuar me kodra, ku spikat një lapidar i bardhë. Me njëherë më pushton mallëngjimi; jo disa ndjenja bashkë... Me siguri disa ndjenja sepse, sapo largohet nga sytë e mi ai horizont i ngushtë, e kthej disa herë kokën prapa e shikoj atë vend ku ka mbetur diçka nga koha e rinisë sime, ku miqësia partizane njohu humbjen e rëndë të shokut, të komandantit, të birit të Mokrës. Nuk di pse ja filloj mbyturazi këngës që na mallëngjente aq shumë atëherë:

"Një tym një mjegull duket/Ca krisma ndihen larg./Një tufë trimash sullen./Me shpirt e zemër flakë."

Nuk po përshkruaj luftën e Pojskës, ku ra Heroi i Popullit Reshit Çollaku, po do të tregoj për Reshitin si njeri, si shok lufte, si komandant...E njoha gjatë pranverës dhe verës së vitit 1942. Atë ditë ai nuk ishte në Pleshisht (baza e partizanëve). Kur u kthye, u ndodha bashkë me Koli Gushon dhe pashë një grumbull partrizanësh që bisedonin. Përnjëherë dallova diçka që më tërhoqi vëmendjen, dhe i them shokut:

A dëshiron të të them cili është Reshiti? Koli më vështroi dhe tundi kokën në shenjë pohimi: Ja ai atje që flet duke lëvizur këmbë e duar.

Si e dallove? Me ndihmën e << psikologjisë >>, i thashë. Shoku qeshi me zemër dhe ja shkoqita më mirë << pse-në >>.

Me të vërtetë Reshiti binte në sy për shkathtësinë, thjeshtësinë dhe zgjuarsinë e tij. Këto tipare spikatnin në çdo cast dhe, bashkë me bukurinë shpirtërore, e bënin të afërt për të tjerët që në njohjen e parë. Kështu ndodhte më të gjithë. Partizanët e donin shumë komandantin e tyre, sepse, para së gjithash, ai ishte shok, mik e njeri...

Një ditë rastisi të shkoja me të në një fshat të Mokrës. Rrugës takuam një fshatar të armatosur, që desh të kalojë pa qëndruar, pasi më hodhi një vështrim me bishtin e syrit, Reshiti e ndali dhe në mënyrë të njerzishme e futi në bisedë të gjërë dhe të gjatë. Siç mu duk e bëri të lëkundet nga pikëpamjet e tij, sepse, kur u largua e pashë që fshatari tundi kokën duke u përshëndetur. Kjo ndodhi atëherë kur Balli Kombëtar nuk ishte demaskuar ende sa duhej. Si u largua ca Reshiti tha; Nuk është i keq po ka miq ballistë që e pengojnë të marrë rrugën e drejtë. Me këtë duhet punuar shumë, që ta shkëputim nga kthetrat e reaksionit.

Një herë tjetër Reshiti më një partizan që nuk e kishte kryer detyrën si duhet. Të them të drejtën se, në fillim u gabova dhe gjykova keq, po në fund u binda plotësisht se sa mirë, sa drejt veprroi komandanti. Fjalët që i tha goditnin fort dhe linini vragë të thellë në ndërgjegjen, pa prekur dinjitetin e pa fyer atë.

Në krahinën e Mokrës, dhe jo vetëm atje, të gjithë e njihnin si një nga organizatorët më të vendosur, më të zjarrtë të luftës kundër fashizmit, që çdo gjë ja kushtonte çështjes së drejtë të popullit dhe atëdheut.

Duke shkruar këto radhe mendova të mos shkruaj dhe të mos përmend luftën e Pojskës, po ja që më del përpara ajo ditë ugruzezë e 16 korrikut 1943. Nuk kam të drejtë të hesht, sepse më duket sikur shoh Reshitin të gjallë, si atë ditë të shkathet, me maliherin e gjatë në krahë që i vetëtimte, me sytë shkëndije, që depërtonin thellë në çdo zemër patrioti. Nuk do të harroj kurrë atë cast, kur u varëm tatpjetë bregut të thepisur e u ndamë në drejtime të ndryshme. Aty e pashë për herë të fundit, të qeshur, të vendosur, plot besim se do ta shpartatllonin armikun. Pas ca orësh mësova lajmin e hidhur. Luftimet nuk kishin mbaruar. Motoskafi qëllonte me top nga liqeni aeroplani fashist mitalronte 50 metra mbi kokat e partizanëve. Sa vështirë! Sa dhimbje! Ishim ulur pranë një gëmushe të vogël për të marrë frymë nga ngjitja e lodhshme, kur na thanë se Reshiti u vra. Nuk mbaj mend cili ishte ai shok, që i shpëtoi pushka nga dora, cili ishte ai që uli kokën për të fshehur lotët, po më kujtohet mirë se mu bë një lësh në grykë. Humbje e rëndë për të gjithë, po asnjë nuk u ligështua. Vetë Reshiti e zinte në gojë shpesh fuqin e kolektivit. Po në kësi rastesh është e pamundur të mos ndodhë diçka e veçantë të njerzjit. E pra, një pjesë e zemrave tona, që e ruante të gjallë Reshitin, u shkëput dhe vajti te ai, e ai tani qëndron aty, buzë liqenit, te lapidari.

Tiranë, 1968